



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
 GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U  
 PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 16925 /10

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDRAVAJTJE NË PRISHTINË,** GJYQTARJA Fadila Hyseni me pjesmarrjen e sekretares juridike Bahrije Krasniqi , duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Nuhri Behxheti nga Prishtina , për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për deklarativin e ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik ,e në bazë të nenit 73,74,195 dhe nenit 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 19.08.2010 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**E PANDEHURA:** Nuhri Islam Behxheti , lindur më 1967 në Dobrosh, tani jeton në Prishtinë në lagjen Dardania SU 6/6 kati 2 nr. 11 me profesion Pedagog në Fakultetin Filozofik , i martur , i gjendje së mesme ekonomike .

**Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s e**

Sepse deri me dt, 31.03.2010 si Zyrtar i lartë në Ministrinë e Arsimit ,Shkencës dhe Teknologjisë si Kshilltar i lartë Politik Agjencionit për antikorrupsion nuk e ka dërguar formularin për Deklarimin e Pasurisë edhe pse i janë dërguar formalët e Agjencionit për Antikorrupsion .

Me qka ka kryer kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontorllin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik . , andaj për këtë

**G J O B I T E T**

Me gjobë në shumën prej 1000(një mijë ) ) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në favor të AFQ të Drejtësisë në xhirollogarinë rrjedhëse 1000430070000518. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (tridhjet ) ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqsor i pandehuri është e obliguar që të paguaj shumën prej 5 € në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

**A r s y e t i m**

**Angjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë,** parashtron kërkesën nr. 01/2299/10 të dt. 08.06.2010 , për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të lartëpërmendurës dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtari inicoi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurin i cili deklaroi : se për mos dërgimin e formularit për deklarimin e pasurisë nuk e ka dërguar organit kompetent pasi ka qenë në lajthim duke menduar se Pasuria deklarohet nëse e njëjta shtohet gjatë ushtrimit të mandatit të Z artarit të lartë e cila gjatë kësaj kohe nuk iu është rritur .

Me rastin e shqiptimi të denimit, gjyqtari vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit ia shqiptoi këtë lloj denimi, duke llogaritur se edhe me këtë do të arrihet efekti i sanksionimit, që i pandehuri në të ardhmen t'i shmanget kryerjes së veprave të këtilla dhe të ngjashme. Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:**Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrorj në ankesë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

G j y q t a r j a  
 Fadila Hyseni

*Fadila Hyseni*

